BASHKIA KORCE
NR 12125 PROT
DATA 18/12/2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# BASHKIA KORÇË

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

# RELACION

# ”PËR DHËNIEN ME HUAPËRDORJE SUBJEKTIT MAKE WITH ICT/ALBANIAN ACADEMY AMBIENTE TË BIBLIOTEKËS PUBLIKE “THIMI MITKO” SIPAS PLAN RILEVIMIT BASHKANGJITUR “

Bashkia Korçë referuar shkresës nr.12079 prot datë 17.12.2024 të subjektit Make ëith ICT /Albanian Academy (shpk) si dhe bazuar në nenet 901-912 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.139/2015”Për vetqeverisjen vendore”i ndryshuar si dhe VKM nr.646 datë 05.10.2022”*Për procedurat ,kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional,nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar ,sipas proçedurave të konkurrimit,për kurset e formimit profesional,të organizuara nga institucionet e formimit profesional,publike apo private*” dëshiron të vendosë në dispozicion ambientet e bibliotekës publike “Thimi Mitko” (kati i pare 23m$^2$,kati i dytë 23m$^2$ dhe 55 m$^2$ ) sipas plan rilevimeve bashkangjitur,në favor të subjektit Make with ICT /Albanian Academy (shpk), për zhvillimin e trajnimeve në fushën e programimit dhe teknologjive, me qëllim zhvillimin e klasave mësimore të akademisë ,duke siguruar kushtet e përshtatshme për ofrimin e këtij shërbimi,

Në këtë objekt ka ushtruar veprimtarinë Subjekti Make with ICT /Albanian Academy (shpk) me Nipt: L82111037U nëpërmjet marrveshjes së bashkëpunimit nr.291 prot datë 12.01.2024, nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe subjektit Make with ICT /Albanian Academy (shpk)
Afati i kësaj marrveshje ka përfunduar.

**Programi i Kodimit** është një nismë e qeverisë shqiptare, e cila synon të zhvillojë aftësitë teknologjike të të rinjve dhe të rriturve, duke ofruar mbështetje financiare për kurse në fushën e programimit. I nisur në janar 2023, ky program implementohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimit (AKPA). Synimi kryesor i programit është rritja e punësimit dhe fuqizimi i burimeve njerëzore me kompetenca në fusha të kërkuara si **Java, web Development**, **Cyber Security**, dhe **Python etj**.

Bashkia Korçë ka luajtur një rol të rëndësishëm në zbatimin dhe suksesin e këtij programi në nivel lokal. Disa nga kontributet kryesore janë:

1. **Pjesëmarrja aktive në organizimin e trajnimeve**: Në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe qendrat e aftësimit profesional që operojnë në Shqipëri, Bashkia Korçë ka siguruar trajnim për mbi **100 të rinj** në fusha të ndryshme të teknologjisë ( si Java, Python, Javascript, Cyber security, ëeb development etj).

2. **Përkrahja e të rinjve**: Bashkia ka krijuar një mjedis mbështetës ( Hubi I teknologjisë Korca Innovation Hub), duke promovuar pjesëmarrjen e të rinjve në trajnime dhe duke mundësuar qasje ndaj burimeve lokale.
3. **Zhvillimi i aftësive për tregun e punës**: Programet si **Java**, **web Development**, dhe **Cyber Security** etj kanë përgatitur të rinjtë për tregun global të teknologjisë, duke u mundësuar atyre të konkurrojnë në një nivel ndërkombëtar.
4. **Fokusimi në inovacion dhe përfshirje**: Bashkia Korçë ka përqendruar përpjekjet e saj në mbështetjen e grupeve të ndryshme, përfshirë ata me më pak mundësi ekonomike, duke i fuqizuar ata për të hyrë në tregun dixhital.

**Rëndësia e Programit në Korçë**

- **Rritja e punësimit**: Programi ka ndihmuar të rinjtë e Korçës të zhvillojnë aftësi që janë shumë të kërkuara nga punëdhënësit lokalë dhe ndërkombëtarë.
- **Nxitja e inovacionit**: Trajnimet në fusha si **Cyber Security** dhe **Python** kanë krijuar bazën për të zhvilluar ide dhe produkte inovative.
- **Zhvillimi ekonomik lokal**: Përmes rritjes së aftësive të fuqisë punëtore, programi kontribuon në zhvillimin ekonomik të zonës.
- **Model bashkëpunimi efektiv**: Bashkia Korçë ka shërbyer si një shembull i suksesshëm i partneritetit mes qeverisë, institucioneve arsimore dhe sektorit privat.

Ky program i ka hapur rrugë të rinjve të Korçës për të përfituar nga teknologjia dhe për të marrë pjesë aktive në transformimin dixhital të vendit. Programi i Kodimit jo vetëm që ndihmon të rinjtë të ndërtojnë karriera premtuese, por edhe forcon rolin e Korçës si një qendër zhvillimi në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.

Dhënia e këtyre ambienteve me huapërdorje kërkon miratimin e Këshillit Bashkiak Korçë.Në këtë kuadër, propozohet dhënia me huapërdorje e ambienteve të Bibliotekës Publike "Thimi Mitko" në qytetin e Korçës subjektit Make with ICT /Albanian ICT Academy .Kontrata e huapërdorjes të jetë me afat deri në 3 (tre) vjet. Kjo kontratë do të përfundojë automatikisht me mbarimin e këtij afati.

Bazuar në nenin 9 pika 1.2 gërmat a) "*njësitë e qeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë .... ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e tyre të paluajtshme sipas mënyrës së përcaktuar në ligj*" *dhe c)* "*e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës*" *dhe pika 1.6 gërma a)* "*e drejta e lidhjes së kontratës*"*si dhe gërma e/1 e nenit 54* "*Këshilli i Bashkisë miraton tjetërsimin e pronave të tretëve*" të ligjit 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" si dhe bazuar në nenet 901-912 të Kodit Civil ***i propozojmë Këshillit Bashkiak Korçë të miratojë dhënien në përdorim me kontratë huapërdorje të ambienteve të sipërpërmendura , identifikuar sipas***

*planvendosjes bashkangjitur ketij relacioni, në favor të subjektit Make with ICT /Albanian Academy, në vashdimësi të marrëveshjes së lidhur në vitin 2024, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së përdorimit të objektit sipas misionit të kësaj shoqërie. Kontrata e huapërdorjes do të ketë një afat 3 vjeçar.*

Bashkangjitur këtij relacioni:

- *Plan rilevim i ambienteve .*

**Drejtore e Përgjithsme Juridike**
**Anxhela (Dishnica) Qeramixhi**

**Drejtore e Qëndrës së Artit dhe Kulturës**
**Zamira Kita**

**Në mungesa dhe me urdhër**

**Zv/Kryetare**

**Besa Spaho**

# AMBIENTE PER HUAPERDORJE
**Sip = 23 m2**




**Hartoi: Ing Arber Gremi**
**nr license : T 1562 DT**
**06.05.2022**

| | KODI | EMERTIMI I HAPESIRES | NJESIA | SIPERFAQE |
|---|---|---|---|---|
| 01 | A- 03 | Nyje higjeno-sanitare | m² | 16.0 |
| 02 | A- 08 | Shkalla e emergjences | m² | 22.8 |
| 03 | A- 15 | Hapesira e leximit/tavolina pune | m² | 152.6 |
| 04 | A- 16 | Ratte librash | m² | 90.1 |
| 05 | A- 19 | Hapesire leximi / e lire | m² | 64.8 |
| | | SIPERFAQE TOTALE KATI | m² | 489.4 |

| | KODI | EMERTIMI I PORTAVE | DIM. CARJE | DIM. PORTE | COPË |
|---|---|---|---|---|---|
| 01 | P- 01 | Dere e brendshme druri cilesi e I-re | 82 x 222 | 80 x 220 | 2 |
| 02 | P- 04 | Dere e brendshme druri cilesi e I-re | 92 x 242 | 90 x 240 | 1 |
| 03 | P- 10 | Dere e jashtme xhami emergjence | 100 x 240 | 100 x 240 | 1 |
| 04 | | | | | |

## Legjende:

- Mure tulle qeramike me vrima
- Mure tulle qeramike dhe polisterol
- Kolona beton-arme
- Mure gipsi
- Vetrate strukturale xhami
- Dyer te brendshme
- Tavan gipsi akustik
- Tavan gipsi i thjeshte
- A- 02 — Emerti i hapesires
- Fc 7.78 — Lartesia e perfunduar
- FF - 3.40 — Kuota e perfunduar
- FS -3.52 — Kuota e struktures
- Lloji i dritares
- B01 — Lloji i muratures
- P02 — Lloji i deres

## Shënime teknike:

- Hapsirat e dritareve dhe dyerve do të respektohen me rigorozitet sipas fletës së projektit arkitektonik dhe tolerancave të dhëna. toleranca në dimensionet e çarjeve është 4 mm. toleranca në respektimin e vertikalitetit është 1mm.
- Në mure do të vendoset brezi antisizmik me gjerësi sa gjerësia e murit dhe lartësi 15 cm. brezi do të armohet me 4 shufra hekuri ø10 dhe stafa ø6 çdo 20 cm.
- Në hapësirat e dyerve, dritareve dhe vetratave do të realizohen arkitrarë betoni me gjerësi sa gjerësia e murit dhe lartësi 15 cm. mbështetja e arkitrarëve nga të dy anët do të jetë minimalisht 20 cm. arkitrarët do të kenë armaturë gjatësore 4ø12 dhe armaturë tërthore ø8 çdo 15 cm.
- Betonimi do të kryhet në temperaturë optimale.
- Gjatë zbatimit të elementëve vertikalë b/a, të tregohet kujdes për ruajtjen me rigorozitet të vertikalitetit të tyre.
- Para se të betonohen kollonat apo muret b/a të secilit kat, të kontrollohen shufrat e rigelave nëse fundet e tyre inkastrohen në kollona/mure nën lartësinë e rigelit.
- Para fillimit të punimeve e gjithë sipërfaqja duhet të pastrohet nga papastërtitë dhe mbeturinat e ngurta.
- Të bëhet piketimi i murit duke u vizatuar linja e tij në soletë. ndarja e mureve do të bëhet duke u orientuar me kollonat.

| | KODI | LLOJI I MURATURES | GJERESIA |
|---|---|---|---|
| 01 | B- 01 | Mur tulle qeramike me vrima 12 | t=12 |
| 02 | B- 02 | Mur tulle qeramike me vrima 20 | t=20 |
| 03 | B- 03 | Mur tulle qeramike me vrima 25 | t=25 |
| 04 | B- 04 | Mur tulle qeramike 30 pa termoizolim | t=30 |
| 05 | B- 05 | Mur tulle qeramike 30 me termoizolim | t=40 |
| 06 | B- 06 | Mur tulle qeramike 35 pa termoizolim | t=35 |
| 07 | B- 07 | Mur beton-arme 30 cm pa termoizolim | t=30 |
| 08 | B- 08 | Mur beton-arme 35 cm me termoizolim | t=40 |
| 09 | B- 09 | Mur gipsi 12 me lesh guri | t=12 |
| 10 | B- 10 | Mur gipsi 20 me lesh guri | t=20 |
| 11 | B- 11 | Mur dekorativ guri 20 | t=20 |

## PLANI I KATIT TE PARE (MOBILIMI)

Faza e projektit: **Projekt Zbatimi**

Shkalla: A2+ / 1:100

Data: 5/2016

Numri i fletës: **A 010**

**AMBIENTE PER HUAPERDORJE**
**SIP = 23 $m^2$**




**Hartoi: Ing Arber Gremi**
**nr license : T 1562 DT**
**06.05.2022**

| | KODI | EMERTIMI I HAPESIRES | NJESIA | SIPERFAQE |
|---|---|---|---|---|
| 01 | A- 03 | Nyje higjeno-sanitare | m² | 16.0 |
| 02 | A- 08 | Shkalla e emergjences | m² | 22.8 |
| 03 | A- 15 | Hapesira e leximit/tavolina pune | m² | 152.6 |
| 04 | A- 16 | Ratte librash | m² | 90.1 |
| 05 | A- 19 | Hapesire leximi / e lire | m² | 28.4 |
| 06 | A- 17 | Salle leksionesh | m² | 68.9 |
| 07 | A- 18 | Salle mbledhjesh/pune ne grup | m² | 39.5 |
| | | SIPERFAQE TOTALE KATI | m² | 515.2 |

| | KODI | EMERTIMI I PORTAVE | DIM. CARJE | DIM. PORTE | COPË |
|---|---|---|---|---|---|
| 01 | P- 01 | Dere e brendshme druri cilesi e I-re | 82 x 222 | 80 x 220 | 2 |
| 02 | P- 04 | Dere e brendshme druri cilesi e I-re | 92 x 242 | 90 x 240 | 2 |
| 03 | P- 10 | Dere e jashtme xhami emergjence | 100 x 240 | 100 x 240 | 1 |
| 04 | P- 08 | Dere e brendshme druri cilesi e I-re | 102 x 242 | 100 x 240 | 1 |
| 05 | | | | | |

**Legjende:**

- Mure tulle qeramike me vrima
- Mure tulle qeramike dhe polisterol
- Kolona beton-arme
- Mure gipsi
- Vetrate strukturale xhami
- Dyer te brendshme
- Tavan gipsi akustik
- Tavan gipsi i thjeshte
- A- 02 / Fc 7.78 — Emerti i hapesires / Lartesia e perfunduar
- FF - 3.40 / FS -3.52 — Kuota e perfunduar / Kuota e struktures
- Lloji i dritares
- B01 — Lloji i muratures
- P02 — Lloji i deres

**Shënime teknike:**

- Hapsirat e dritareve dhe dyerve do të respektohen me rigorozitet sipas fletës së projektit arkitektonik dhe tolerancave të dhëna. toleranca në dimensionet e çarjeve është 4 mm. toleranca në respektimin e vertikalitetit është 1mm.
- Në mure do të vendoset brezi antisizmik me gjerësi sa gjerësia e murit dhe lartësi 15 cm. brezi do të armohet me 4 shufra hekuri ø10 dhe stafa ø6 çdo 20 cm.
- Në hapësirat e dyerve, dritareve dhe vetratave do të realizohen arkitrarë betoni me gjerësi sa gjerësia e murit dhe lartësi 15 cm. mbështetja e arkitrarëve nga të dy anët do të jetë minimalisht 20 cm. arkitrarët do të kenë armaturë gjatësore 4ø12 dhe armaturë tërthore ø8 çdo 15 cm.
- Betonimi do të kryhet në temperaturë optimale.
- Gjatë zbatimit të elementëve vertikalë b/a, të tregohet kujdes për ruajtjen me rigorozitet të vertikalitetit të tyre.
- Para se të betonohen kollonat apo muret b/a të secilit kat, të kontrollohen shufrat e rigelave nëse fundet e tyre inkastrohen në kollona/mure nën lartësinë e rigelit.
- Para fillimit të punimeve e gjithë sipërfaqja duhet të pastrohet nga papastërtitë dhe mbeturinat e ngurta.
- Të bëhet piketimi i murit duke u vizatuar linja e tij në soletë. ndarja e mureve do të bëhet duke u orientuar me kollonat.

| | KODI | LLOJI I MURATURES | GJERESIA |
|---|---|---|---|
| 01 | B- 01 | Mur tulle qeramike me vrima 12 | t=12 |
| 02 | B- 02 | Mur tulle qeramike me vrima 20 | t=20 |
| 03 | B- 03 | Mur tulle qeramike me vrima 25 | t=25 |
| 04 | B- 04 | Mur tulle qeramike 30 pa termoizolim | t=30 |
| 05 | B- 05 | Mur tulle qeramike 30 me termoizolim | t=40 |
| 06 | B- 06 | Mur tulle qeramike 35 pa termoizolim | t=35 |
| 07 | B- 07 | Mur beton-arme 30 cm pa termoizolim | t=30 |
| 08 | B- 08 | Mur beton-arme 35 cm me termoizolim | t=40 |
| 09 | B- 09 | Mur gipsi 12 me lesh guri | t=12 |
| 10 | B- 10 | Mur gipsi 20 me lesh guri | t=20 |
| 11 | B- 11 | Mur dekorativ guri 20 | t=20 |

Emërtimi i fletës:
**PLANI I KATIT TE DYTE (MOBILIMI)**

Faza e projektit:
**Projekt Zbatimi**

Numri i fletës:
**A 012**

Shkalla:
A2+ / 1:100

Data:
5/2016




| | KODI | EMERTIMI I HAPESIRES | NJESIA | SIPERFAQE |
|---|---|---|---|---|
| 01 | A- 03 | Nyje higjeno-sanitare | m² | 16.0 |
| 02 | A- 08 | Shkalla e emergjences | m² | 22.8 |
| 03 | A- 15 | Hapesira e leximit/tavolina pune | m² | 152.6 |
| 04 | A- 16 | Rafte librash | m² | 90.1 |
| 05 | A- 19 | Hapesire leximi / e lire | m² | 28.4 |
| 06 | A- 17 | Salle leksionesh | m² | 68.9 |
| 07 | A- 18 | Salle mbledhjesh/pune ne grup | m² | 39.5 |
| | | **SIPERFAQE TOTALE KATI** | m² | **515.2** |

| | KODI | EMERTIMI I PORTAVE | DIM. CARJE | DIM. PORTE | COPË |
|---|---|---|---|---|---|
| 01 | P- 01 | Dere e brendshme druri cilesi e l-re | 82 x 222 | 80 x 220 | 2 |
| 02 | P- 04 | Dere e brendshme druri cilesi e l-re | 92 x 242 | 90 x 240 | 2 |
| 03 | P- 10 | Dere e jashtme xhami emergjence | 100 x 240 | 100 x 240 | 1 |
| 04 | P- 08 | Dere e brendshme druri cilesi e l-re | 102 x 242 | 100 x 240 | 1 |
| 05 | | | | | |

## Legjende:

- Mure tulle qeramike me vrima
- Mure tulle qeramike dhe polisterol
- Kolona beton-arme
- Mure gipsi
- Vetrate strukturale xhami
- Dyer te brendshme
- Tavan gipsi akustik
- Tavan gipsi i thjeshte
- A- 02 Emerti i hapesires
- Fc 7.78 Lartesia e perfunduar
- FF - 3.40 Kuota e perfunduar
- FS -3.52 Kuota e struktures
- Lloji i dritares
- B01 Lloji i muratures
- P02 Lloji i deres

## Shënime teknike:

- Hapsirat e dritareve dhe dyerve do të respektohen me rigorozitet sipas fletës së projektit arkitektonik dhe tolerancave të dhëna. toleranca në dimensionet e çarjeve është 4 mm. toleranca në respektimin e vertikalitetit është 1mm.
- Në mure do të vendoset brezi antisizmik me gjerësi sa gjerësia e murit dhe lartësi 15 cm. brezi do të armohet me 4 shufra hekuri ø10 dhe stafa ø6 çdo 20 cm.
- Në hapësirat e dyerve, dritareve dhe vetratave do të realizohen arkitrarë betoni me gjerësi sa gjerësia e murit dhe lartësi 15 cm. mbështetja e arkitrarëve nga të dy anët do të jetë minimalisht 20 cm. arkitrarët do të kenë armaturë gjatësore 4ø12 dhe armaturë tërthore ø8 çdo 15 cm.
- Betonimi do të kryhet në temperaturë optimale.
- Gjatë zbatimit të elementëve vertikalë b/a, të tregohet kujdes për ruajtjen me rigorozitet të vertikalitetit të tyre.
- Para se të betonohen kollonat apo muret b/a të secilit kat, të kontrollohen shufrat e rigelave nëse fundet e tyre inkastrohen në kollona/mure nën lartësinë e rigelit.
- Para fillimit të punimeve e gjithë sipërfaqja duhet të pastrohet nga papastërtitë dhe mbeturinat e ngurta.
- Të bëhet piketimi i murit duke u vizatuar linja e tij në soletë. ndarja e mureve do të bëhet duke u orientuar me kollonat.

| | KODI | LLOJI I MURATURES | GJERESIA |
|---|---|---|---|
| 01 | B- 01 | Mur tulle qeramike me vrima 12 | t=12 |
| 02 | B- 02 | Mur tulle qeramike me vrima 20 | t=20 |
| 03 | B- 03 | Mur tulle qeramike me vrima 25 | t=25 |
| 04 | B- 04 | Mur tulle qeramike 30 pa termoizolim | t=30 |
| 05 | B- 05 | Mur tulle qeramike 30 me termoizolim | t=40 |
| 06 | B- 06 | Mur tulle qeramike 35 pa termoizolim | t=35 |
| 07 | B- 07 | Mur beton-arme 30 cm pa termoizolim | t=30 |
| 08 | B- 08 | Mur beton-arme 35 cm me termoizolim | t=40 |
| 09 | B- 09 | Mur gipsi 12 me lesh guri | t=12 |
| 10 | B- 10 | Mur gipsi 20 me lesh guri | t=20 |
| 11 | B- 11 | Mur dekorativ guri 20 | t=20 |

**AMBIENTE PER HUAPERDORJE**
**SIP = 5.5 m²**

**Hartoi: Ing Arber Gremi**
**nr license : T 1562 DT**
**06.05.2022**

Emërtimi i fletës:
**PLANI I KATIT TE DYTE (MOBILIMI)**

Faza e projektit:
**Projekt Zbatimi**

Numri i fletës:
**A 012**

Shkalla:
A2+ / 1:100

Data:
5/2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**P/ V E N D I M**

**Nr_____, datë _____/___/2024**

**"PËR DHËNIEN ME HUAPËRDORJE SUBJEKTIT MAKE WITH ICT/ALBANIAN ACADEMY AMBIENTE TË BIBLIOTEKËS PUBLIKE "THIMI MITKO" SIPAS PLAN RILEVIMIT BASHKANGJITUR "**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Pergjithshme Juridike bazuar në dispozitat e neneve 9 pika 1.2 gërmat a) *dhe c); ne nenin 54 pika 1.6 gërma a dhe gërma e/1* të ligjit 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" si dhe bazuar në nenet 901-912 të Kodit Civi dhe në VKM nr.646 datë 05.10.2022"*Për procedurat ,kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional,nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar ,sipas proçedurave të konkurrimit,për kurset e formimit profesional,të organizuara nga institucionet e formimit profesional,publike apo private*",dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dhënien me huapërdorje të ambienteve të Bibliotekës Publike "Thimi Mitko" (kati i pare 23m$^2$,kati i dytë 23m$^2$ dhe 55 m$^2$ ) sipas plan rilevimeve bashkangjitur,në favor të subjektit Make with ICT /Albanian Academy (shpk), për zhvillimin e trajnimeve në fushën e programimit dhe teknologjive, me qëllim zhvillimin e klasave mësimore të akademisë .

2. Të autorizohet Kryetari i Bashkisë të fillojë procedurat ligjore për dhënien me huapërdorje të këtyre ambienteve.

3. Afati i dhënies me huapërdorje do të jetë 3(tre)vjet.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Qëndra e Artit dhe Kulturës.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me ________vota

Vota Pro ______

Vota Kundër _______

Vota Abstenim __________

Zbardhur më datë _________

K R Y E T A R

ANA VERUSHI